



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 9
16.04.2014

NR. VENDIMI 6
17.04.2014

V E N D I M

«Për Sekuestrim Pasurie»

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë e përbërë prej

GJYQTAR: LUAN HASNEZIRI

Asistuar nga sekretare seance **Lavdie HYSAJ**, sot në datë 17.04.2014, ora 10.30, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën penale Nr.9 Regj. me:

KËRKUESE: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar nga **prokurori Besnik MUÇI**.

KUNDËR:

SHTETASIT **1.K.N.**, i biri i P. dhe M., i dtl.
xxx, lindur fshatin xxx, Komuna xxx, xxx, banesë private.

OBJEKTI:

1- Sekuestrimin e pasurive të meposhtme:

a- Shumës prej xxx Euro dhe xxx lekë
Mjetin tip xxx me targa xxx.

2. Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohen Zyrat e Përmbartimit të Rretheve **xxx, ndërsa për Administrimin dhe përdorimin** e pasurive Z. K.Xh., i cili është Administrator në Agjensinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Në përfundim të gjykimit gjykata, pasi e gjeti veten kompetente për të gjykuar dhe vendosur mbi kërkesën e paraqitur, në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, pasi dëgjoi pretendimin përfundimtar të prokurorit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit të saj

V Ë R E N

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në datë xxx, regjistroi procedimin pasuror Nr. x Viti xxx, në ngarkim të shtetasit K.N., si person i dyshuar për kryerje të veprës penale « Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve », parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

Ky procedim pasuror është rregjistruar si rrjedhojë e procedimit penal Nr. xx, te vitit xxx, të rregjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në ngarkim të shtetasve A.M., B.E., B.D., M.O., A.T., G.Xh. për veprën penale të «Trafikimit të narkotikëve», si dhe në ngarkim të shtetasit K.N. i dyshuar për kryerjen e veprës penale të «Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve», parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

Nga materiali hetimor i procedimit penal nr. xx të vitit xxx, të administruar edhe për llogari të procedimit pasuror Nr. x të vitit xxx të Prokurorisë për Krime të Rënda, rezultoi sa më poshtë:

Se shtetasi K.N. në datën xxx i ka shitur shtetasit A.T. një sasi prej xxx kg lëndë narkotike e llojit Cannabis Sattiva, dhe në datën xxx i është seksuetruar një sasi prej xxx kg lëndë narkotike e llojit Cannabis Sattiva. Prokuroria për Krime të Rënda, në përfundim të hetimit i ka njoftuar shtetasit K.N. akuzën e «Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve», parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal dhe ka vendosur dërgimin në Gjyq të çeshjes penale në ngarkim të tij.

Nga aktet e hetimit të procedimit penal në ngarkim të shtetasit K.N. ka rezultuar se atij në momentin e arrestimit i janë gjetur dhe sekuestruar një sasi prej xxx (xxx) euro dhe xxx (xxx) lekë, dhe mjetin tip xxx me targa xxx së bashku me dokumentacionin e tij.

Në kushtet e mësipërme, organi i Prokurorisë për Krime të Rënda pretendon se ekziston dyshimi i arsyeshëm i mbështetur ne prova se shtetasi K.N. ka kryer veprën penale të «Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve», parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

Ndodhur në të tilla rrethana, nga ana e organit procedues filluan procedurat për vendosjen e masave parandaluese ndaj pasurive, duke qënë se kjo vepër penale hyn në kategorinë e atyre të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 «Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive », dhe si rrjedhojë dhe për këtë shtetas sipas nenit 3/1 të këtij ligji duhet të kryhet hetim pasuror dhe të aplikohen masat e parashikuara nga ky ligj.

Nga verifikimet pasurore të kryera për llogari të procedimit pasuror në ngarkim të shtetasit K.N., ka rezultuar se ai disponon dhe pasurinë e llojit arë me nr. xxx, regjistruar në zonën kadastrale nr. xxx, volumi x faqja xx, në xxx xxx, në datën xxx. Kjo pasuri është krijuar para periudhës së aktivitetit kriminal si dhe para vitit xxx, periudhë e cila përkon përpara hyrjes në fuqi dhe shtritjes së efekteve të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 « Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive». Në këto kushte bazuar në nenin 3/4 të këtij ligji, ky ligj nuk zbatohet për këtë pasuri.

Gjithashtu, nga Prokuroria për Krime të Rënda janë kryer dhe verifikime lidhur me të ardhurat e shtetasit K.N. dhe sipas përgjigjeve të ardhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me nr. xxx datë xxx dhe QKR me nr. xxx datë xxx, ky shtetas nuk figuron i regjistruar në organet tatimore për ushtrimin e ndonjë aktiviteti privat dhe nuk figuron të jetë regjistruar në regjistrin tregtar.

Në këto kushte, është evindentuar fakti se shtetasi K.N. nuk rezulton që të ketë të ardhura të tjera nga burime të ligjshme për të justifikuar shumën prej xxx (xxx) Euro dhe xxx (xxx) lekë që dispononte në momentin e arrestimit në flagrancë.

Nga faktet e sipërpërmendura, rezulton që pasuria shuma prej xxx (xxx) Euro dhe xxx, është në pronësi të shtetasit nën hetim dhe i është kapur atij. Për këtë pasuri nga policia gjyqësore, gjatë arrestimit të shtetasit K.N. është vendosur sekuestrimi i tyre, akt i cili është vleftësuar i ligjshëm nga Prokurori.

Nga hetimet e deritanishme të kryera për llogari të procedimit pasuror, ka rezultuar se pasuria e mësipërme është krijuar pas periudhës së aktivitetit

kriminal dhe pas vitit xxx, viti i hyrjes në fuqi dhe shtritjes së efekteve të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 «Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive» dhe si rrjedhojë ky ligj zbatohet për këtë pasuri.

Në datë xxx, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë paraqiti para kësaj Gjykate, kërkesën me objekt sekuestrimin e pasurive të përshkruara më sipër, duke patur si bazë ligjore Ligjin Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjykata, në respektim të kërkesave të nenit 12 pika 1 të Ligjit në fjalë, brenda afatit ligjor pesëditor, të parashikuar në këtë dispozitë, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën e paraqitur.

Në kërkesë dhe në seancë gjyqësore prokurori pretendoi se:

1. Ekziston dyshimi i arsyeshem i bazuar në prova se shtetasi K.N. ka kryer veprën penale të «Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve», parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, e cila hyn në kategorinë e veprave penale të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 «Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive », dhe si rrjedhojë ky shtetas sipas nenit 3/1 të këtij ligji është subjekt i këtij ligji dhe i hetimit pasuror.

2. Ne momentin e arrestimit të shtetasit K.N., i është gjetur dhe sekuestruar shuma prej xxx (xxx) Euro dhe xxx (xxx) lekë dhe mjetin tip xxx me targa xxx së bashku me dokumentacionin e tij, veprim i cili është vleftësuar i ligjshëm nga prokurori. Nga ana e organit procedues janë kryer verifikime lidhur me të ardhurat e shtetasit K.N. dhe sipas përgjigjeve të ardhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me nr. xxx datë xxx dhe QKR me nr. xxx datë xxx, ky shtetas nuk figuron i regjistruar në organet tatimore për ushtrimin e ndonjë aktiviteti privat dhe nuk figuron të jetë regjistruar në regjistrin tregtar, dhe për rrjedhojë nuk justifikon shumën monetare të sekuestruar ndaj tij gjatë arrestimit.

3. Nga hetimet e deritanishme, ka rezultuar se pasuria e mësipërme në pronësi të shtetasit K.N., është krijuar pas periudhës së aktivitetit kriminal dhe pas vitit xxx, viti i hyrjes në fuqi dhe shtrijes së efekteve të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 « Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive», dhe si rrjedhojë ky ligj

zbatohet për këtë pasuri.

4. Çështja penale në ngarkim të shtetasit K.N. është në përfundim të gjyqimit të saj dhe me qëllim gjetjen dhe ruajtjen e këtyre pasurive, pasi ekziston një rrezik real dhe potencial që kjo pasuri të tjetërsohet dhe të humbasë, është e nevojshme vendosja e masës së sekuestrimit në bazë të nenit 11/1/a të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009.

- Në funksion të provueshmërisë së pretendimeve dhe kërkesës në gjykim, prokurori paraqiti si provë aktet që kishin të bënin me regjistrimin e procedimit penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Skallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, procesverbali për sekuestrimin e sendeve të shtetasit K.N., të shumave prej xxx (xxx) Euro dhe xxx (xxx) lekë, si dhe mjetin tip xxx me targa xxx së bashku me dokumentacionin e tij, të pasqyruara “*në procesverbal për sekuestrimin provave materiale, mbajtur më datë xxx nga O.P.Gj. I.M.*” “*Vendim për vleftësimin e sekuestros*” i datës xxx i Prokurorit A.B. për vleftësimin e ligjshëm të seksuetrimin të kryer nga O.P.Gj. I.M.; shkresat e drejtuara institucioneve në lidhje me aktivitetet tregtare apo të ardhurat e shtetasit K.N. si: Shkresa nr. xxx datë xxx e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve lidhur me shtetasin K.N., Shkresa nr. xxx datë xxx e QKR lidhur me lidhur me shtetasin K.N.; Shkresa nr. xxx datë xxx i ZRPP xxx lidhur me pasuritë e shtetasit K.N.

Gjykata në analizë të pretendimeve të prokurorit dhe provave të paraqitura prej tij, çmon se kërkesa është e drejtë, e bazuar ligj dhe prova dhe si e tillë duhet të pranohet për këto arsye:

I.Kërkesa u paraqit në zbatim të nenit 3 të Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të titulluar “Fusha e zbatimit”.

Sipas pikës 1 të këtij neni, ligji gjen zbatim për pasuritë e personave mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicje, për kryerjen prej tyre të një sërë veprash penale në të cilat përfshihet edhe vepra penale «Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve», parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

U provua në gjykim se shtetasi K.N. është person nën hetim për kryerje të veprës penale «Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve», për të cilën është proceduar Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krime të Rënda Tiranë

dhe tashmë ndodhet në gjykim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Shuma e sekuestruar shtetasit K.N. gjatë momentit të arrestimit të tij; Mungesa e ndonjë aktiviteti tregëtar, të regjistruar në emër të tij apo të familjarëve; Mungesa e pasurive të palujtëshme nga të cilat të mund të gjenerohen të ardhura;

II. Në interpretim dhe zbatim të nenit 11 të ligjit, gjykata çmon se për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë është e domosdoshme ekzistenca njëkohësisht e dy kriterëve të përgjithshme që kanë të bëjnë me:

1. Ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në indicje që tregojnë se personat mund të jenë të përfshirë në veprimtari kriminale.

2. Zotërimin e pasurive dhe të ardhurave që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre, si dhe

Ekzistenca e të paktën njërit prej kriterëve të veçanta, të parashikuara në pikat “a” dhe “b” të këtij neni.

Përsa më sipër, u arsyetua se mbi shtetasin K.N. rëndon dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në indicje, për përfshirjen e tij në veprimtarinë kriminale të «Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve», parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

Shtetasi K.N. nuk ka të rregjistruar asnjë aktivitet tregtar dhe asnjë të ardhur tjetër të ligjshme që të mund të justifikojë shumat e sekuestruara ndaj tij gjatë momentit të arrestimit.

Ekziston rreziku real për tjetërsimin pasurisë. Duke qënë se ndaj shtetasit K.N. është duke u zhvilluar një proces gjyqësor me akuzën e kryerjes së veprës penale të «Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve», parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, i cili është drejt përfundimit, rrezikohet që pasuria e sekuestruar shtetasit K.N. të tjetërsohet ose të humbasë.

Në bazë të pikës 2 të nenit 14 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, pasi gjykata vlerësoi praninë e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për vendosjen e masës së sekuestros, çmon se ekziston detyrimi që të njoftojë zotëruesin e pasurive të sekuestruara për vendimin e marrë prej saj. Në zbatim të kësaj dispozite, për realizimin e njoftimit zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 130, 131, 132 dhe 133 të Kodit të Proçedurës Civile. Duke qënë se gjykata e gjeti kërkesën e paraqitur të drejtë dhe ligjore, vendimi i saj duhet t'i njoftohet

shtetasit nën hetim K.N.

Në bazë të pikës 3 të nenit 14 dhe pikës 1 të nenit 15 të Ligjit në fjalë, kompetente për ekzekutimin e vendimit të sekuestrimit të pasurive janë përmbaruesit gjyqësorë dhe për administrimin e tyre administratorët e Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Në këto kushte, është detyrim ligjor për gjykatën që në vendimin e saj të urdhërojë zyrën e përmbarimit, në juridiksionin e të cilës ndodhet pasuria e luajtshme (neni 516 i Kodit të Proçedurës Civile) dhe, një administrator të agjensisë, të cilët do të koordinojnë punën për zbatimin e vendimit të sekuestrimit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në bazë të nenit 3 pika 1 gërma “d”, nenit 7 pika 1 dhe 2, nenit 11 pika 1 gërma “a”, nenit 12 pika 1 dhe 2, nenit 14 pika 2 dhe 3, nenit 15 pika 1 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

V E N D O S

Pranimin e kërkesës.

Vendosjen e masës së sekuestrimit mbi pasuritë e shtetasit K.N., të përbërë prej:

1. Shumës prej xxx (xxx) Euro dhe xxx (xxx) lekë
2. Mjetin tip xxx me targa xxx.

Për ekzekutimin e vendimit të sekuestrimit ngarkohet Zyra e Përmbarimit Gjyqësor në xxx dhe, për administrimin e pasurisë së sekuestruar, administratori K.Xh., në Agjensinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

Urdhërohet K/Sekretaria, pranë kësaj Gjykate, t'i njoftojë shtetasit K.N. vendimin e sekuestrimit.

Kundër vendimit lejohet e drejta e ankimit të veçantë, brenda afatit ligjor, në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

U shpall sot në Tiranë, në datë 17.04.2014, ora 11.00.

SEKRETARE

Lavdie HYSAJ

GJYQTAR

Luan HASNEZIRI

